



Datë/Datum/Date	14.09.2021	Referencë/e Nr./Br.	Prishtinë / Priština 2291-2021
Për/Za/To	Subjektet Politike të Certifikuara për Zgjedhjet Lokale 2021		
Nga/Od/From	Kreshnik Radoniqi, Kryesues – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)		
Kopje/Kopija/CC	Arkiva		
Tema/Subjekat/Subject:	Zbatimi i masave kundër COVID-19 për aktivitetet zgjedhore		

Të nderuar Kryetarë të Subjekteve Politike të Certifikuara,
Të nderuar Persona Kontaktues të Subjekteve Politike të Certifikuara,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është duke vazhduar me kryerjen e aktiviteteve brenda mandatit të vet ligjor duke përfshirë edhe komunikimin e rregullt dhe këshillimin e subjekteve politike.

Siç jeni të njoftuar paraprakisht, institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrinë e Shëndetësisë janë duke monitoruar vazhdimisht gjendjen e pandemisë COVID 19 në Kosovë dhe duke përcaktuar masat mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit varësisht nga gjendja ku ndodhet vendi.

Të gjitha masat e miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Qeveria), qofshin ato për kufizim të lëvizjes, kufizim të tubimeve, kufizim apo kushtëzim të qasjes në objekte dhe institucione publike apo hapësira tjera janë të obligueshme edhe për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për juve si subjekte politike të certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale 2021. Rrjedhimisht, kërkojmë nga Ju që të inkurajoni të gjithë përfaqësuesit tuaj dhe të nominuarit tuaj që t'u përmbahen udhëzimeve të institucioneve publike të Republikës së Kosovës përgjegjëse për shëndetin publik.

Më saktë, KËRKOJMË nga Ju që të inkurajoni seriozisht të gjithë të nominuarit tuaj për staf të zgjedhjeve (anëtarë të këshillave të vendvotimeve) dhe për vëzhgues për qasje në objekte t'i respektojnë masat e miratuara nga Qeveria dhe ta posedojnë të paktën njërin nga dokumentet si në vijim:

1. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një dozë të vaksinës kundër COVID-19;
2. Testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
3. Dëshminë që personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave serologjik IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve);
4. Testin e shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.

KQZ inkurajon VAKSINIMIN e stafit zgjedhor dhe vëzhguesve. Vaksinimi përveç që kontribuon pozitivisht në shëndetin publik në përgjithësi, do të ju jep edhe qasje të plotë në objektet që KQZ do të shfrytëzoj për proces zgjedhor dhe votim.